



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 34 (827939)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 gusht 2025

Dekorime për forcat e emergjencës, Kryeministri Rama: Kapitali njerëzor është garancia e Shqipërisë



» faqe 3



25 VITE RRUGËTIM, NGA THEMELET TEK MODERNIZIMI

Intervistë ekskluzive me Komandantin e Forcës Tokësore të FARSH, Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në kuadër të 25-vjetorit të krijimit të Forcës Tokësore, kemi kënaqësinë dhe nderin të zhvillojmë një bisedë ekskluzive me Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandantin e kësaj Force. Për herë të parë në këtë format, Gjeneralmajori sjell një... »

faqe 4



NGA KANUNI TE INTEGRIMI EVROPIAN, TRAJEKTORJA E CIVILIZIMIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

Sami Frashëri, në veprën e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, shkruan qartë se një popull i paarsimuar, i paorganizuar dhe i pandriçuar nuk mund të quhet i civilizuar. Pra, ai e lidh drejtpërdrejt civilizimin me dijen, vetëdijen dhe organizimin kombëtar. Pas Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen e regjimit komunist, ideja e civilizimit u shndërrua sërish. Regjimi e paraqiste veten si emancipues të popullit nga... »

faqe 7



ORKESTRA E USHTRISË SHQIPTARE: DIPLOMACI NË SKENË, MAGJI MBI DET

Muzika shqiptare ngjitet në skenat ndërkombëtare dhe rikthehet me magji mbi nëndetësen historike 105. Përgjatë vitit 2025, Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura ka dëshmuar se arti është një mjet i fuqishëm diplomacie dhe identiteti kombëtar. Muzikantët shqiptarë kanë përfaqësuar vendin me dinjitet në Francë, ndërsa në brigjet e Pashalimanit kanë sjellë një performancë unike që ndërthur historinë ushtarake me fuqinë... »

faqe 6

Stërvitje e përbashkët në Detin Egje: “LISSUS” P-133 dhe “RUEGEN” A1453 në veprim

Anija “LISSUS” P-133 e Forcave të Armatosura Shqiptare zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane A 1453 “RUEGEN”, si pjesë e misionit të NATO-s në Detin Egje.

Gjatë kësaj stërvitjeje, u testuan aftësitë operacionale dhe u zhvilluan skenarë për:

- Maksimizimin e veprimeve - Për të siguruar një koordinim efikas midis forcave.
- Menaxhimin e situatave emergjente - Rritja e gatishmërisë për të përballuar rreziqet e mundshme.
- Rritjen e ndërveprimit në det - Forcimi i bashkëpunimit midis anijeve.

Ky aktivitet ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe përmirësimin e ndërveprimit mes forcave të përfshira, duke kontribuar në rritjen e gatishmërisë për përmbushjen e suksesshme të misioneve të ardhshme.



EOD vijon operacionet e pastrimit nga municionet e paplasura në Vlorë, Kolonjë dhe Kurbin

Operatorët e Njërive të Çminimit (EOD) kanë vijuar me intensitet punën e tyre në disa bashki të vendit, duke kryer operacione të rëndësishme për pastrimin e sipërfaqeve nga municionet e paplasura.

Me profesionalizëm dhe përkushtim, specialistët kanë përfunduar me sukses detyra në bashkitë Vlorë, Kolonjë dhe Kurbin, duke identifikuar dhe larguar municione të rrezikshme që përbënin kërcënim serioz për jetën e banorëve.

Ky kontribut i përditshëm i ekspertëve EOD është i pazëvendësueshëm, pasi shndërron tokën dhe hapësirat ujore në ambiente të sigurta për komunitetet dhe krijon kushte të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Operacionet e çminimit mbeten një hallkë thelbësore në mbështetje të strukturave të Emergjencave Civile dhe në rritjen e sigurisë publike në vend.



Shqipëria dhe Kosova forcojnë bashkëpunimin ushtarak me stërvitjen nënujore në Pashaliman

Efektivët e Qendrës së Zhytjes të Forcës Detare zhvilluan në bazën detare të Pashalimanit një stërvitje të përbashkët me kolegët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kjo veprimtari, tashmë e kthyer në një traditë të qëndrueshme, synon të garantojë rritjen e operacionalitetit, forcimin e ndërveprimit dhe zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta për misionet nënujore.

Stërvitja vjen si dëshmi e bashkëpunimit të ngushtë mes dy forcave, duke forcuar më tej partneritetin dhe besimin reciprok në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



Dekorime për forcat e emergjencës, Kryeministri Rama: Kapitali njerëzor është garancia e Shqipërisë

Tiranë – U zhvillua ceremonia e Mirënjohjes Kombëtare në nderim të forcave të angazhuara në operacionet e shpëtimit dhe fikjes së zjarreve që përfshinë vendin gjatë kësaj vere.

Kryeministri Edi Rama dekoroi me Medaljen e Mirënjohjes Publike dhe Vlerësimit Profesional disa prej efektivëve të policisë, ushtrisë dhe zjarrfikësve që u dalluan për guxim e përkushtim. Ai theksoi se kjo është një shenjë simbolike falënderimi, por mbi të gjitha një mesazh për të gjithë trupën që u përball me flakët.

Mes të dekoruarve me Yllin e Mirënjohjes Publike ishte komisar Agim Troci, i cili u plagos teksa shpëtoi banorë të bllokuar nga zjarret. Po ashtu, këtë medalje e morën edhe kolonel Gëzim Marku dhe nënkolonel Ervin Buzi.

Me Medalje Ari u nderuan: inspektor Klajdi Mustaj, nënkolonel Euklid Jemini, nënkolonel Vladimir Nasufi, Ilirjan Hasanaj, zjarrfikësit Klodian Fishta, Ahmet Beqo, Besnik Hasani, kryeinspektor Ilir Llapushi dhe zjarrfikësi Ilir Sinani.

Medalje Argjendi morën: nënkomisar Eridion Lame, inspektore Laura Leka, nënkolonel Aleksandër Sine, major Ermal Radomi, toger Saimir Shemi, rreshter Indrit Shehi dhe tetar Vasil Leno.

Ndërsa me Medalje Bronzi u vlerësuan: oficer Andi Gjura, nëntoger Denis Gaba, rreshter Granita Hasanaj dhe ushtar Brisild Xhaçka. Në fjalën e tij, kryeministri Rama theksoi se kapitali njerëzor i vendit u bë garancia më e madhe për të ndaluar një tragjedi të përmasave masive.


“Në përballje me flakët dhe temperaturat e ferrit të verës, Shqipëria tregoi se ka një potencial njerëzor që nuk e lë kurrë vendin në baltë. Sakrifica e tyre ndali atë që mund të ishte një asgjësim mjedisor, ekonomik, moral e njerëzor”, - u shpreh kryeministri Rama.

Ai vuri në dukje se pavarësisht ndihmës së huaj me helikopterë e avionë, beteja fitohet mbi tokë me sakrificën e njerëzve me uniformë. Rama falënderoi në mënyrë të veçantë Emiratet e Bashkuara Arabe, vendet e Bashkimit Evropian, si dhe aleatët rajonalë që dërguan ndihmë ajrore.

Kreu i qeverisë theksoi se Shqipëria do të ndërtojë së shpejti një flotë të sajën me avionë zjarrfikës, duke investuar njëkohësisht në parandalim, teknologji inteligjente, pastrim pyjesh dhe përdorim dronësh për monitorim.

Kryeministri Rama solli në vëmendje edhe bilancin tragjik të zjarreve në Mesdhe, duke theksuar se solidariteti dhe përkushtimi i forcave shqiptare bëri që vendi ynë të shmangte pasojat katastrofike.

“Kjo është e vërteta e thjeshtë: Shqipërinë nuk e mbrojtën kritikët online, por djersa, guximi dhe sakrifica e mbi 10 mijë njerëzve në vijën e zjarrit”, - nënvizoi ai. Ceremonia e Mirënjohjes Kombëtare u mbyll me zotimin e qeverisë për të rritur mbështetjen financiare dhe përmirësuar më tej sistemin e mbrojtjes civile, duke e kthyer këtë përvojë në një hap drejt forcimit të kapaciteteve kombëtare të emergjencave.





INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në kuadër të 25-vjetorit të krijimit të Forcës Tokësore, kemi kënaqësinë dhe nderin të zhvillojmë një bisedë ekskluzive me Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandantin e kësaj Force. Për herë të parë në këtë format, Gjeneralmajori sjell një panoramë të plotë historike dhe profesionale: nga ditët e para të themelimit të Forcës Tokësore dhe komandantët që udhëhoqën atë periudhë të vështirë, tek transformimi i saj sipas standardeve të NATO-s, si dhe sfidat që janë tejkaluar në rrugën e modernizimit.

Në këtë intervistë, Gjeneralmajor Xhebexhia ndalet jo vetëm te rruga e zhvillimit të institucionit që drejton, por edhe te përvoja e tij personale si ushtarak dhe drejtues, duke ndarë vizionin për të ardhmen e Forcës Tokësore dhe rolin që ajo do të ketë në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

I nderuar Gjeneralmajor Xhebexhia, kush ishin figurat dhe komandantët që kontribuuan në ngritjen e Forcës Tokësore? Cilat ishin sfidat e para?

Forca Tokësore, nga krijimi e deri më sot, është drejtuar nga komandantë me eksperiencë, të cilët sot kemi nderin t'i kemi shumicën prezentë në këtë ceremoni modeste. Kështu, nga viti 2000-2006, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Kostaq Karoli (i cili nuk ndodhet më mes nesh), prej vitit 2006-2007, u drejtua nga gjeneralmajor Shpëtim Spahiu dhe nga viti 2010 deri në gusht 2012, kjo Forcë u drejtua nga gjeneralmajor Viktor Berdo. Prej gushtit 2012 deri në nëntor 2015, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Zyber Dushku. Nga muaji nëntor 2015 e deri në muajin janar 2019, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Nazmi Cahani. Prej muajit shkurt 2019 - tetor 2020, u drejtua nga gjeneral brigade Albert Mullai. Nga viti 2020-2022, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneral brigade Arben Kingji. Ndërsa nga viti 2023 e në vazhdim, Forca Tokësore drejtohet nga gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Forca Tokësore krijohej në një vit kur shteti kishte sfida të mëdha në drejtim të organizimit, sigurisë, shkatërrimi i vitit 1997, si dhe sfidat për riorganizim të vazhdueshëm sipas modeleve bashkëkohore të vendeve PFP dhe NATO.

Ndër sfidat e para mund të përmendim riorganizimin e njësive pas ngjarjeve të vitit 1997, me fokus transformimin, stërvitjen dhe trajnimin, në përmbushje të misionit kushtetues si dhe përballimin e sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që shfaqeshin gjatë pjesëmarrjes në misionet paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit, në kuadër të operacioneve ushtarake të NATO-s në Afganistan, Irak, Bosnje-Hercegovine.

Si ka ndryshuar roli i Forcës Tokësore nga vitet e para e deri sot?

Forca Tokësore përbën bazën e Forcave të Armatosura dhe strukturën ushtarake më të madhe të tyre. Ajo është forca ushtarake përgjegjëse për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve tokësore luftarake dhe jo luftarake që rrjedhin nga misioni dhe detyrat e Forcave të Armatosura.

Megjithatë roli i saj ka ndryshuar ndër vite, duke kaluar ndryshime strukturore të vazhdueshme për ngritjen dhe zhvillimin e strukturave dhe kapaciteteve, në përshtatje me kërkesat që kërkonte rruga e gjatë për të arritur qëllim final të anëtarësimit të NATO, në vitin 2009.

Këto ndryshime kanë bërë që Forca Tokësore nga një konsumues i sigurisë në vitet e para të ndërtimit të saj është shndërruar në prodhues të sigurisë në rajon dhe më gjerë, falë eksperiencës së gjatë në misione, stërvitje ndërkombëtare, trajnim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim me aleatët dhe partnerët, duke fituar besimin e tyre si një forcë e besueshme dhe e aftë të vepronte në teatrin operacional.

Cilat janë momentet më të rëndësishme historike që shënojnë rrugëtimin e këtyre 25 viteve?

- Forca Tokësore në krijimin e saj, më datë 29 gusht 2000, përfshinte në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo u krijua mbi bazën e 5 divizionesh këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione, të përhapur në 167 rajone të ndryshme të vendit.

- Në vitin 2006, suprimohet Forca Tokësore dhe krijohet Komanda e Forcës së Bashkuar.

- Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura bazuar edhe në konceptin e një ushtrie sa më të vogël në numër dhe sa më operacionale e profesioniste, më 9 dhjetor 2009, u dekretua ri-krijimi i Forcës Tokësore mbi bazën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Regjimentit Komando.

- Forca Tokësore, duke filluar nga 1 nëntori i vitit 2023, ka kaluar në Strukturën e Re Organizative, e cila konsiston në një forcë ushtarake më efektive, e kompletuar me personel, e mirë-pajisur me armatim dhe teknikë të avancuar, e mirë-trajnuar, të stërvitur dhe të motivuar, të gatshme dhe të aftë të kryejnë misionin e tyre kushtetues në mbrojtje të vendit, si dhe duke vepruar në përbërje të Aleancës, në respekt të vlerave, sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë.

- Një risi e këtyre ndryshimeve strukturore është atashimi i komponentit rezervist krahas personelit aktiv. Aktivizimi dhe integrimi i kësaj force rezerviste, do mbështesë trupat aktive në mjedisin operacional të përbashkët si dhe i shërben rritjes së kapaciteteve dhe aftësisë operacionale për t'u përballur me rreziqet dhe kërcënimet të identifikuara në mjedisin aktual të sigurisë.

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME KOMANDANTIN E FORCËS TOKËSORE TË FARSH, GJENERALMAJOR ILIR XHEBEXHIA

25 vite rrugëtim, nga themelet tek modernizimi



Komandant i Forcës Tokësore,
Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia

Çfarë roli ka Forca Tokësore në zhvillimet e sigurisë rajonale në Ballkan?

Koncepti strategjik i NATO-s thekson se vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida dhe kërcënime mes të cilave është dhe ndërhyrja dashakeqe e vendeve të treta.

Kompasi Strategjik i BE-së thekson se siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor nuk janë të garantuara dhe ekziston frika reale e destabilizimit dhe përkeqësimit të situatës së sigurisë.

Politikë mbrojtëse dhe paqësore: politika e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë nuk paragjykon asnjë shtet si armik dhe nuk ka asnjë synim të cenojë tërësinë territoriale, sovranitetin, apo pavarësinë e shteteve të tjera.

Forca Tokësore përbën bazën e Forcave të Armatosura dhe strukturën ushtarake më të madhe të tyre dhe rrjedhimisht është element thelbësor i fuqisë kombëtare si pjesë e FA-së dhe kontribuon në ruajtjen e sigurisë në rajon, duke realizuar misionin e saj kushtetues.

Krahas kësaj, FT angazhohet në Planet e Bashkëpunimit Ushtarak Dypalëshe duke marrë pjesë në stërvitje të përbashkëta, trajnime të ndryshme me qëllimin e vetëm për rritjen e besimit midis Forcave Tokësore për të demonstruar praktikisht jo vetëm atë që ne e kemi të deklaruar në dokumente strategjike (Politikë mbrojtëse dhe paqësore) por dhe rritjen e ndërveprimit mes Forcave Tokësore të vendeve respektive të BP.

Si ndihmon Forca Tokësore në forcimin e sigurisë së NATO-s në juglindje të Evropës?

Vendndodhja gjeografike e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor e bën një pjesë të rëndësishme të rrjetit të rrugëve pan europiane, që NATO synon të përdorë si pjesë e Korridorit VIII për të rritur sigurinë në krahun lindor të NATO-s.

Korridorit VIII synon pritjen e forcave aleate, duke vënë në dispozicion infrastrukturën portuale dhe rrjetin e rrugëve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt të lëvizjes nëpërmjet përdorimit të Forcës Tokësore për sigurimin e rrugëkalimit.

Krahas sigurimit të infrastrukturës portuale dhe asaj të rrugëkalimit, FT merr pjesë në stërvitje të përbashkëta në interes të rritjes së sigurisë në juglindje të Evropës. Qëllimi kryesor është identifikimi i dobësive apo pikave kritike që kërkojnë ndërhyrje si dhe përmirësimi i veprimeve të përbashkëta për të rritur ndërveprueshmërinë në rast dislokimi për në krahun lindor.

Gjithashtu FT merr pjesë me trupa dhe me pozicione shtabi në komanda të ndryshme në juglindje të Evropës, duke kontribuar drejtpërsëdrejti në operacionet e NATO-s dhe rritjen e sigurisë në rajonin juglindor të Evropës.

Çfarë marrëdhëniesh keni me forcat e armatosura të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi?

Marrëdhëniet do t'i konsideroja si të shkëlqyera, pasi prej vitesh respektivisht kemi Plane Bashkëpunimi Ushtarak Dypalëshe me të gjitha këto vende të rajonit. Gjithashtu kemi të konsoliduara Plane me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut si dhe Kosovën. Këto plane synojnë ngritjen e kapaciteteve, rritjen e besimit, profesionalizmit, ndërveprimin nëpërmjet stërvitjeve e trajnimeve të përbashkëta si dhe shkëmbimin e eksperiencave përmes vizitave reciproke të punës.

Këto marrëdhënie demonstrohen më së miri dhe në rastet e angazhimit të Forcës Tokësore në menaxhimin e emergjencave civile për shkak të fatkeqësive natyrore (Covid-19 në Itali, zjarret në Greqi, dhe termeti në Turqi).

Cilat janë mësimet e nxjerra nga stërvitjet e përbashkëta, si “Defender Europe”?

FT tashmë është një Forcë e konsoliduar që ka marrë pjesë në shumë stërvitje ndërkombëtare dhe ka eksperiencën e duhur për të vepruar në çdo teatër operacional. Kur them ka eksperiencë, kam parasysh që nga ushtari deri tek planëzimi i shtabeve në mjedis ndërkombëtar dinë si të veprojnë dhe operojnë.

Megjithatë stërvitja “Defender Europe” është një stërvitje me karakter të veçantë, për arsye se zhvillohet për të testuar kapacitetet infrastrukturorë në rast dislokimi të forcave të NATO-s apo një nisme bilaterale. Përsëri fokusi është tek ndërveprueshmëria, zbatimi i standardeve të NATO-s dhe aftësia për t'u dislokuar dhe ri-dislokuar në një kohë të shkurtër.

Mësimet të identifikuara do të veçoja dy më kryesoret, të cilat janë përmirësimi i infrastrukturës si vend pritës dhe modernizimi me sisteme të ndërveprueshme me aleatët dhe anëtarë të NATO-s, të dyja këto mësimet të nxjerra janë adresuar dhe punohet në vazhdimësi për stërvitjet e ardhme të paketës “Defender Europe”.

Këto seri stërvitjesh janë zhvilluar tre herë në Shqipëri që nga viti 2021, 2023 dhe 2025 dhe në dy herët e fundit shqipëria ka patur drejtimin e brigadës shumëkombëshe kjo si rezultat i përfatësimit

dinjitoz., rritjes profesionale dhe punës së palodhur të ushtarakëve të FT dhe FA ndër vite.

Ku qëndron sot Forca Tokësore në raport me modernizimin?

Në kuadër të përmbushjes së misionit kushtetues dhe detyrave kryesore që rrjedhin prej tij, detyrimeve ndaj Aleancës, si dhe bazuar në Politikat e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, Vizionin e SHSHPFA, PAZH, Direktivën e Mbrojtjes, në Forcën Tokësore, vijon procesi i modernizimit të strukturave operacionale për përmbushjen e kërkesave të Objektivave të Kapaciteteve të deklaruara në NATO; me prioritet Grup-Batalionin e Këmbësisorisë së Lehtë (GBKL) dhe Grupit Tokësor Special i Organizuar për Detyrë (SOLTG), të cilët janë dy nga Objektivat Kryesore të kapaciteteve të NATO-s, me synim përmirësimin e kapaciteteve operacionale ekzistuese si dhe ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja operacionale, me qëllim rritjen e Kapaciteteve të Luftimit (C), Mbështetjes së Luftimit (CS) si dhe Mbështetjes më Shërbime të Luftimit (CSS).

Në këtë kontekst, dua të theksoj se lista e projekteve të cilat mbështesin modernizimin e strukturave të Forcës Tokësore është e gjatë, disa prej të cilëve janë në fazë implementimi dhe disa projekte të reja, por unë do doja të veçoja disa prej tyre si:

- Projekti i modernizimit të strukturave të Forcës Tokësore me armatim të ri, të unifikuar individual dhe kolektiv për forcat aktive dhe ato rezerviste;
- Projekti i Sistemeve/pajisjeve të Zbulimit për neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot;
- Projekti i modernizimit të Qendrës MADM në FT, duke e vlerësuar edhe si kapacitet kombëtar;
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Tanke “JAVELIN”.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Ajrore “STINGER”.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit të të gjitha reparteve të FT me GHLKT, tip i ri, 84/246mm, standard NATO.
- Projekti “Pajisje speciale xheniere”, si kapacitet për mbështetjen xheniere të veprimeve luftarake të FT/FARSH dhe mbështetjen e popullatës civile në rast emergjence (tërmete, zjarre, përmbytje) dhe pastrimin e “Hot-Spoteve”.
- Projekti i modernizimit të mbështetjes së trupave me luftim, për rritjen e fuqisë së zjarrit direkt dhe indirekt, nëpërmjet sistemit të ri të mortajave 120mm të montuara mbi mjet, sistemeve të artilerisë 105mm dhe 155mm.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit të strukturave operacionale të FT-së me mjete taktike të blinduara (JLTV) me kalueshmëri e manovrueshmëri të lartë, për të siguruar mbrojtjen e forcave, lëvizshmërinë si dhe dislokimit të shpejtë të trupave në operacione brenda e jashtë vendit.
- Sistemi i Menaxhimit i Fushëbetejës (Battle Management System).
- Kompletimi me mjete taktike të kalueshmërisë së lartë për të gjithë strukturat e Forcës Tokësore.

Procesi i modernizimit të strukturave operacionale me prioritet Grup Batalionin e Këmbësisorisë së Lehtë/GBKL dhe SOLTG, do t'i shërbejë rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve operacionale në interes të certifikimit të radhës nga NATO të GBKL dhe SOLTG gjatë vitit 2026, në përmbushje detyrimeve të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s, si dhe angazhimit tonë ndaj Aleancës.

Me këtë rast, nuk mund të lija pa përmendur mbështetjen e dhënë nga Ministri i Mbrojtjes, Shefi i SHPFA për modernizimin, përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të strukturave të FT-së, si dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me aleatin strategjik SHBA, veçanërisht me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, Komandën Amerikane në Evropë/USAREUR, Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak Amerikan, ODC si dhe ekipeve trajnuese të SFAB-it, i atashuar pranë GBKL, të cilët kanë dhënë dhe po japin një kontribut të pazëvendësueshëm, për mbështetjen, trajnimin, stërvitjen e përbashkët, si dhe modernizimin e FT-së për të qenë të ndërveprueshëm dhe të aftë për kryerjen e misionit kushtetues.

Gjithashtu, dua të theksoj se vijimi i procesit të modernizimit të Forcës Tokësore në funksion të përmbushjes së Objektivave të Kapaciteteve të përcaktuara në Samitin e NATO-s në Hagë, ishte në qendër të takimit të parë konsultativ, që ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi në Komandën e Forcës Tokësore, nga ku nisi zyrtarisht punën për Rivlerësimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM).

Çfarë pajisjesh dhe teknologjish të reja pritet të futen në shërbim?

Procesi i modernizmit në FT vijon bazuar në PAZH FT 2024-2033 dhe detyrimet e procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s (NDPP-CT-25), duke synuar përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese si dhe ngritjen e Kapaciteteve të luftimit, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit, bazuar në zhvillimet e fundit teknologjike, të cilat janë të ndërveprueshme me aleatët në përmbushje të kërkesave të Objektivave të Kapaciteteve.

Ndër to mund të përmendim:

- Projekti i Sistemeve/pajisjeve të Zbulimit për neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot (drone Buster dhe Drone Gun).
- Sisteme të avancuara për zbulim, identifikim dhe përcaktim objektivash në fushën e luftimit (mjete të avancuara të fluturimit pa pilot, sistem sensorësh dhe radarësh për zbulim, vrojtim e përcaktim objektivash).
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Tanke, “JAVELIN”.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Ajrore “STINGER”.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit të të gjitha reparteve të FT-së me GHLKT, tip i ri, 84/246mm, standard NATO.
- Projekti “Pajisje speciale xheniere”.
- Projekti i modernizimit të mbështetjes me zjarr nëpërmjet sistemit të ri të mortajave 120mm të montuara mbi mjet, sistemeve të artilerisë 105mm dhe 155mm.
- Projekti i modernizimit dhe kompletimit të strukturave operacionale të FT-së me mjete taktike të blinduara (JLTV/APC).

- Sistemi i Menaxhimit i Fushëbetejës (Battle Management System).

Si po investohet tek trajtimi i ushtarit, pajisjet personale, mbrojtja dhe motivimi?

Ndër objektivat kryesorë të punës në FT është menaxhimi sa më i mirë i Burimeve Njerëzore për mbështetjen, mbrojtjen dhe motivimin e personelit.

Mbështetja me burime njerëzore të nevojshme për përmbushjen e misionit të FT-së, është konsideruar si një prioritet për zhvillimin e forcës, bazuar në nivelet operacionale të kërkuara, zhvillimin dhe trajtimin e personelit si dhe në standardizimin e procedurave të punës në fushën e personelit.

Motivimi i personelit është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, arsimimit, kualifikimit dhe ecurisë në karrierë nëpërmjet shanseve të barabarta.

Në drejtim të Mbajtjes së personelit është treguar shumë kujdes, në identifikimin dhe promovimin në grada dhe detyrë, ato ushtarakë të cilët sigurojnë vijueshmëri shërbimi në strukturat e FT-së, jemi përpjekur që çdo ushtarak, pikë së pari, duhet ta ndjejë vetën se ka kontribuar dhe ka mundësi të kontribuojë për FT-në, se është i vlefshëm në funksionin e tij organik dhe se FT dhe ushtaraku janë në një marrëdhënie simbiotike në mes tyre.

Përkujdesja ndaj personelit sa më sipër, është realizuar edhe nëpërmjet investimeve në infrastrukturën stërvitore, promovimit të karrierës ushtarake, rritjes së trajtimit financiar, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, kushteve të punës dhe kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjarët e tyre.

Disa nga nismat e qeverisë për mbështetjen dhe motivimin e personelit janë:

- nisma e vitit 2023 për dhënien e kuotave çdo vit për kredi të reja me interes 0%, për ushtarakët aktivë/punonjësit civilë të Forcave të Armatosura.
- nisma e vitit 2024, për rritjen e trajtimit financiar që tashmë është bërë realitet që prej 1 janarit 2025, me fokus trajtimin dinjitoz të efektivëve ushtarakë.

Për sa më sipër gjej rastin, që në emër të gjithë personelit të Forcës Tokësore, të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e thellë për Ministrin e Mbrojtjes e Shefin e SHPFA për mbështetjen e dhënë.

Cilat janë kontributet më të rëndësishme të ushtarëve tanë në misionet ndërkombëtare?

Nisur nga misioni kushtetues i FARSH, baza ligjore e përcaktuar, si dhe në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në luftë kundër terrorizmit, strukturat e Forcës Tokësore kanë qenë dhe janë pjesëmarrëse aktive në operacione ndërkombëtare në misione paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike.

Më 9 shtator 1996, FT, në kuadër të FARSH, ka filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë për një periudhë kohore 6-muaj. Më pas, numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione e misione paqeruajtëse apo luftarake, si operacioni “Liria e Irakut”, Irak, ISAF dhe RSM Afganistan, Çad, Gjeorgji, Mali, Sudani i Jugut, Kosovë, eFP Letoni, eVA Bullgari.

Kontribute të FT-së, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator i vitit 1996, deri në muajin dhjetor 2024 , janë gjithsej 7062 personel.

Aktualisht, gjatë vitit 2025, Forca Tokësore, është e angazhuar në misione paqeruajtëse në Bosnje-Hercegovinë (misioni ALTHEA), në Kosovë (misioni KFOR-3, KFOR 6, KFOR 8, KFOR-12), eFP Letoni, misioni eVA-VI në Bullgari, misioni “INTERFLEX, Mbretëria e Bashkuar, misioni ORF “KFOR-I” Kosovë, Misioni ORF (shtab), me gjithsej personel 308 personel dhe 63 mjete.

Me këtë rast, dëshiroj të siguroj Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e SHPFA, se të gjitha strukturat e FT-së të dislokuara në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, në kuadër të NATO-s, BE dhe OKB-së, si dhe strukturat që po përgatiten të dislokohen në rotacionet e misioneve të radhës, kryejnë dhe do të kryejnë me profesionalizëm dhe me dinjitet të gjitha detyrat operacionale të dhëna nga komandat eprore ndërkombëtare.

Kontributi i FT-së në misione jashtë vendit në kuadër të operacioneve ushtarake të NATO-s, BE, OKB, ka qenë gjithmonë i vlerësuar maksimalisht nga komandat eprore ndërkombëtare për angazhimin, profesionalizmin dhe përkushtimin në realizimin e detyrave të ngarkuara, gjë që fatkeqësisht e dëshmon dhe humbja e jetës së “Dëshmorit të Atdheut”, Kapiten Feti Vogli, në Afganistan.

Çfarë përvoje ka sjellë misioni në Afganistan dhe si po shfrytëzohet ajo sot?

Pjesëmarrja në misione paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit solli një eksperiencë të re në drejtim të ndërveprueshmërisë, aplikimit të standardeve të NATO-s, rritjen e kërkesave të gatishmërisë si dhe rritjen e profesionalizmit të ushtarakëve tanë, të cilët përballeshin me kërcënime e rreziqe jo konvencionale. Kjo eksperiencë po shfrytëzohet në teatrot aktuale, kjo si pasojë e globalizmit, duke qenë se lufta ndaj terrorizmit ngelet një kërcënim aktual pavarësisht shfaqjes në një nivel më të ulët.

Kjo eksperiencë përçohet më tej nëpërmjet stërvitjes para-dislokuese me kushtet e misionit e drejtuar nga ushtarakë të cilët kanë një eksperiencë të gjatë në misionet e operacionet jashtë vendit.

Si e përshkruani rolin e Forcës Tokësore në emergjencat civile?

Forca Tokësore, në përmbushje të misionit kushtetues, krahas rolit dhe përgjegjësisë tradicionale ushtarake, ka qenë e angazhuar dhe kontribuar në operacionet e Emergjencave Civile në mbështetje të autoriteteve vendore dhe komunitetit, në operacione për shuarje zjarri, bllokim nga dëbora, përmbytje, për përballimin e pasojave të tërmetit

të nëntorit 2019, zhvendosje kimikatesh, pastrim territori, mbështetje të IKMT, në menaxhimin e pasojave nga virusi “COVID-19, etj., me një angazhim total prej 225277 forcash dhe 18651 mjtesh.

Ndërhyrjet më të suksesshme në përballimin e fatkeqësive natyrore kanë angazhimi në operacione për shuarje zjarri, përmbytje, për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, si dhe në menaxhimin e parandalimin e pasojave nga virusi “COVID-19.

A ka plane për të rritur kapacitetet e ndihmës ndaj popullsisë në raste emergjencash?

Forca Tokësore po zhvillon kapacitete të ndihmës ndaj popullsisë në raste emergjencash më përputhje me detyrimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

Aktualisht në kuadër të Modernizimit të kapaciteteve të FARSH në FT po zbatohet projekti “Kompletim me mjete dhe pajisje për operacionet e emergjencave civile/SAR”.

FT zhvillon stërvitje dhe trajnime specifike për përballimin e EC në rast zjarresh, tërmetesh, përmbytjesh, incidentesh industriale dhe operacionesh kërkim-shpëtimi/SAR.

Çfarë stërvitjesh madhore janë planifikuar për vitet në vijim?

Forca Tokësore, do vijojë të jetë e angazhuar për planëzim dhe ekzekutim me profesionalizëm e disiplinë të lartë edhe stërvitjet e planëzuara për periudhën në vijim, ku mund të përmendim: Stërvitjen 3-shkallëshe me dislokim trupash e koduar “Mburoja Dardane-25” (06-09 tetor), “Golden Sword-25” në bashkëpunim me Greqinë, “JCET ALB-TURKIYE-25” me pjesëmarrjen e FS/ROS.

Gjithashtu, prioritet për Forcën Tokësore për vitin 2026 e në vijim, ndër të tjera, do të jenë:

- “Mburoja e Arbrit-26” (14-23 shtator 2026), stërvitja vlerësuese e GBKL në rajonin stërvitor Zall-Herr dhe Bizë.
- “Mburoja Ilire-26” (03-13 nëntor 2026), stërvitja vlerësuese e SOLTG/ROS.
- Paketa e stërvitjeve të përvitshme “KFOR Rotation” si pjesë e paketës së stërvitjeve KFOR, në Gjermani.
- “Mburoja Ilire 27”, është stërvitje dimërore e planëzuar për t’u zhvilluar në periudhën 29 nëntor deri në 04 dhjetor 2027 nga batalioni Komando, rajonin stërvitor të Bizës, në kushtet e vështira dhe të ftohta të motit.
- “Mburoja Albane 28”, është stërvitje e planëzuar për t’u zhvilluar nga data 18- 23 Shtator 2028, nga Regjimenti i Këmbësisorisë të Jugut.
- “Mburoja Dardane 29”, është stërvitje e planëzuar për t’u zhvilluar në shtator 2029, nga Regjimenti i Këmbësisorisë së Veriut, në rajonin stërvitor Mnelë.
- Pjesëmarrja në serinë e stërvitjeve “Defender Europe”.

Si po konsolidohen strukturat e brendshme të Forcës Tokësore?

FT nëpërmjet PAZH të FT 2024-2033, synon të unifikojë dhe adresojë zhvillimin e gjithë veprimtarisë afatgjatë të strukturave të vartësisë, për hartimin e planeve periodike vjetore, zhvillimin e kapaciteteve operacionale, të harmonizojë dhe integrojë gjithë ciklin e planifikimit, programimit, buxhetimit për zhvillimin e burimeve të mbrojtjes, në personel, stërvitje, armatime, pajisje, sisteme, infrastrukturë, etj.

Aktualisht FT po implementon strukturën e re, duke filluar nga 1 nëntori i vitit 2023, e cila konsiston në një forcë ushtarake më efektive, e kompletuar me personel, e mirë-pajisur me armatim dhe teknikë të avancuar, e mirë-trajnuar, të stërvitura dhe të motivuara, të gatshme dhe të afta të kryejnë misionin e tyre kushtetues në mbrojtje të vendit, si dhe duke vepruar në përbërje të Aleancës, në respekt të vlerave, sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë.

Një risi e këtyre ndryshimeve strukturore është atashimi i komponentit rezervist krahas personelit aktiv. Aktivizimi dhe integrimi i kësaj force rezerviste, do mbështesë trupat aktivë në mjedisin operacional të përbashkët si dhe i shërben rritjes së kapaciteteve dhe aftësisë operacionale për t’u përballur me rreziqet dhe kërcënimet të identifikuara në mjedisin aktual të sigurisë.

Ajo çfarë duhet të kuptojmë është se, që të ndërtosh një kapacitet kërkon kohë, burime financiare dhe resurse njerëzore të trajnuara dhe duhet të kalojë në spektrin e plotë (DOTMLPF). FT i ka konkretizuar këto plane në Programet e Mbrojtjes, Listën e Integruar të Prioriteteve për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve sipas planifikimit në PAZH FT.

Si e shihni Forcën Tokësore pas 10 apo 20 vitesh?

Forcë Tokësore e kompletuar, e mirë-trajnuar, e mirë-stërvitur, e mirë-motivuar, e ndërveprueshme dhe e aftë për dislokim/ri-dislokim në vete, brenda dhe jashtë vendit, etj., për të kryer detyra luftarake dhe jo-luftarake në përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimet ndaj NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Çfarë mesazhi do t’u përcillnit brezave të rinj që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj?

Mesazhi që dua të përcjell për të rinjtë dhe qytetarët e Shqipërisë në këtë rast 25-vjetori është se duhet të kuptojnë se situata e sigurisë ka ndryshuar, qëndrojmë në një kohë ku konfliktet janë shtuar si në Europë dhe në Lindjen e Mesme dhe kontributi Juaj mund të jetë i vlefshëm kurdoherë.

Rikthimi tek vlerat e larta të atdhedashurisë dhe mbështetja tek ajo pjesë e shoqërisë (Forcat e Armatosura) që janë një model për t’u ndjekur dhe një shembull i sakrificës së pakursyer se si mund t’i shërbesh Atdheut.

U bëj thirrje të rinjve shqiptarë që të bëhen pjesë FA/FT, pasi aty do të gjejnë mundësi për një karrierë të suksesshme dhe të gjatë, mundësi zhvillimi profesional në fusha të ndryshme, përkujdesje shëndetësore dhe trajtim dinjitoz financiar.

Nëse do ta përmbliidhnit Forcën Tokësore në tre fjalë, cilat do të ishin ato?

Përkushtim-Profesionalizëm-Disiplinë.

Orkestra e Ushtrisë Shqiptare:

DIPLOMACI NË SKENË, MAGJI MBI DET

Muzika shqiptare ngjitet në skenat ndërkombëtare dhe rikthehet me magji mbi nëndetësen historike 105.

Përgjatë vitit 2025, Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura ka dëshmuar se arti është një mjet i fuqishëm diplomacie dhe identiteti kombëtar. Muzikantët shqiptarë kanë përfaqësuar vendin me dinjitet në Francë, ndërsa në brigjet e Pashalimanit kanë sjellë një performancë unike që ndërthur historinë ushtarake me fuqinë e tingullit simfonik.

Kuinteti “VIVO” debutoi në Festivalin Ndërkombëtar Eurochestries, duke u bërë formacioni i parë shqiptar pjesëmarrës në këtë ngjarje prestigjioze.

Kuarteti “TOGHA” solli muzikën dhe këngët popullore shqiptare në Festivalin “Périgord Noir”, ku Shqipëria ishte vend i nderit.

Në Pashaliman, mbi nëndetësen 105, OSFA interpretoi veprën “Ritfolk”, duke krijuar një atmosferë të rrallë mes tingujve dhe historisë.

Ky sukses i jashtëzakonshëm dëshmon se muzika shqiptare ka zë, ka shpirt dhe është e gatshme të flasë me botën, duke e vendosur Forcën e Armatosur në një rol të ri, mbrojtëse të sigurisë, trashëgimisë dhe kulturës kombëtare.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Nga Kanuni te Integrimi Evropian, trajektorja e civilizimit në kontekstin shqiptar



Çfarë është civilizimi dhe pse ka rëndësi?
Civilizimi, në kuptimin më të gjerë të fjalës, nënkupton një shkallë të caktuar zhvillimi kulturor, social dhe institucional të një shoqërie. Ai nuk është vetëm teknologji, ndërtime apo pasuri materiale, por një mënyrë e të jetuarit, një sistem vlerash, normash, ndërgjegjeje dhe marrëdhëniesh njerëzore që formësojnë një shoqëri të organizuar. Në kontekstin shqiptar, koncepti i civilizimit është kuptuar dhe interpretuar në mënyra të ndryshme gjatë shekujve, shpeshherë në varësi të rrethanave historike, ndikimeve të jashtme dhe sfidave të brendshme.

Civilizimi në mendësinë tradicionale shqiptare, ndërmjet nderit dhe kanunit
Në periudhën e hershme të historisë shqiptare, sidomos në zonat malore dhe më pak të prekura nga pushtetet qendrore, civilizimi nuk kuptohej në kuptimin e institucioneve moderne apo zhvillimit teknologjik, por si një sistem rregullash zakonore, më konkretisht Kanuni.

Kanuni i Lekë Dukagjinit, përfaqësonte një formë të organizuar të jetës sociale dhe juridike. Njeriu i “civilizuar” ishte ai që respektonte rregullin, nderin, mikpritjen, besën dhe ndershmërinë. Pra, civilizimi ishte më shumë një nocion etik dhe moral sesa material apo institucional. Megjithatë ky sistem ruante një rend shoqëror, ai ishte edhe i kufizuar nga struktura patriarkale dhe logjika e gjakmarrjes, që e bënte shpesh të egër dhe arkaik në sytë e standardeve moderne të civilizimit.

Ndikimi i qytetërimeve të huaja,
Perandoria Osmane dhe Perëndimi
Pushtimi osman solli me vete një model tjetër të civilizimit, atë të një perandorie me rend, fe islame, arkitekturë, sistem gjyqësor dhe organizim të mirëfilltë administrativ. Një pjesë e popullsisë shqiptare, sidomos në qytete, e përvetësoi këtë model, duke u integruar në strukturat osmane dhe duke e lidhur konceptin e civilizimit me edukatën e oborrit, fenë, dhe rendin.

Nga ana tjetër, shqiptarët që jetonin më afër viseve të influencuara nga Evropa Perëndimore (si Shkodra, Korça apo Gjirokastra), filluan të përthithnin ide të tjera të civilizimit përmes shkollave françeskanë, jezuite, greke apo arumune që theksonin arsimimin, qytetërimin urban, laicitetin dhe vetëdijen kombëtare.

Në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX, Shqipëria ishte një mozaik pikëpamjesh mbi civilizimin, disa e kuptonin atë si përlulesi fetare dhe rend osman, të tjerë si përparim shkencor, kulturor dhe kombëtar në modelin evropian.

Rilindja Kombëtare: Civilizimi si identitet kombëtar dhe emancipim

Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1830-1912) shënon një pikë kthese të madhe në mënyrën se si u kuptua civilizimi në Shqipëri. Rilindësit, si Sami Frashëri, Pashko Vasa, Naim Frashëri e të tjerë, e panë civilizimin si një mjet për çlirimin kombëtar dhe përparimin e popullit shqiptar.

Në këtë periudhë, civilizimi nuk ishte më vetëm një nocion etik apo juridik, por një synim strategjik.

Me civilizim kuptohej arsimimi i popullit, përdorimi i gjuhës shqipe, zhvillimi i shtypit, emancipimi i grave dhe krijimi i institucioneve kombëtare.

Sam Frashëri, në veprën e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, shkruan qartë se një popull i paarsimuar, i paorganizuar dhe i pandriçuar nuk mund të quhet i civilizuar. Pra, ai e lidh drejtpërdrejt civilizimin me dijen, vetëdijen dhe organizimin kombëtar.

Shqipëria komuniste -
Civilizimi si kontroll dhe barazi me dhunë
Pas Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen e

regjimit komunist, ideja e civilizimit u shndërrua sërish. Regjimi e paraqiste veten si emancipues të popullit nga “prapambetja, analfabetizmi dhe zakonet feudale”, duke promovuar një formë të imponuar të civilizimit, ateizëm zyrtar, barazi absolute, zhdukje e fesë, dhe kultivimi i njeriut të ri socialist.

Në pamje të parë, mund të duket se u bë progres, u zhdur analfabetizmi, u ndërtuan shkolla, spitale, uzina, dhe u modernizuan disa aspekte të jetës.

Por kjo “rrugë drejt civilizimit” ishte e shtrembëruar nga mungesa e lirisë individuale, dhuna shtetërore dhe izolimi total nga bota. Civilizimi u reduktua në propagandë. Nuk kishte vend për ndjeshmëri kulturore, për pluralizëm mendimesh apo për ndërtimin e një shoqërie të hapur. Kështu, shumë vlera të mirëfillta të civilizimit perëndimor, si demokracia, e drejta e fjalës, liria personale u konsideruan “armiqësore”.

Pas komunizmit, civilizimi i keqkuptuar si kopjim i verbër

Pas vitit 1990, Shqipëria kaloi nga një sistem i mbyllur në një realitet të ri, kaotik dhe shpesh të pakuptueshëm. Në këtë periudhë tranzicioni, civilizimi u keqkuptua shpesh si kopjim i pamjes së jashtme të Perëndimit mënyra e veshjes, teknologjia, markat, ndërtimet pa plan, apo liria absolute pa përgjegjësi.

Në vend që civilizimi të lidhej me kulturën e komunikimit, respektin për ligjin, tolerancën, dhe zhvillimin institucional, ai u reduktua në shfaqje luksi, individualizëm ekstrem, konsumizëm dhe informalitet të thellë.

Kemi ndërtuar qytete pa urbanizëm, jemi lidhur me botën përmes teknologjisë, por kemi harruar vlerat thelbësore të bashkëjetesës, kulturës qytetare dhe respektit për tjetrin. Kemi kopjuar Perëndimin në formë, por jo në përmbajtje.

A jemi shoqëri e civilizuar sot? Një pyetje ende e hapur...

Në ditët e sotme, Shqipëria ndodhet në një udhëkryq mes së kaluarës së saj të përçarë dhe një të ardhmeje që synon Evropën. Megjithatë, civilizimi vazhdon të jetë një koncept i paqartë dhe shpesh i zbrazët nga përmbajtja.

Kur drejtësia funksionon për të fortët dhe jo për të drejtën, nuk jemi të civilizuar. Kur rrugët ndërtohen por nuk respektohen rregullat, nuk jemi të civilizuar. Kur fëmijët mësojnë teknologjinë por jo etikën, nuk jemi të civilizuar. Kur liria keqpërdoret si anarki, nuk është civilizim, është kaos.

Rrugët drejt një civilizimi të mirëfilltë shqiptar
Historia shqiptare ka treguar se civilizimi është kuptuar në mënyra të ndryshme si rend zakonor, si përlulesi fetare, si nacionalizëm arsimor, si barazi komuniste, apo si kopjim liberal. Por asnjë nga këto forma nuk ka arritur të ndërtojë plotësisht një shoqëri të balancuar, të drejtë dhe të zhvilluar.

Civilizimi i vërtetë në Shqipëri duhet të ndërtohet mbi:

- arsim cilësor dhe etikë qytetare,
- shtet të drejtë dhe institucione funksionale,
- respekt për të drejtën, për tjetrin dhe për natyrën,
- dialog kulturor dhe vetëdije historike.

Vetëm atëherë do të mund të themi se Shqipëria ka hyrë realisht në një epokë të civilizimit të qëndrueshëm jo si pamje, por si përmbajtje.

IN MEMORIAM



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Një jetë në Xhenio: Musa Bileri, inxhinieri që fortifikoi mbrojtjen

Më 28 gusht, bëhen plot 30 vjet kur në moshën 66-vjeçare u nda nga jeta inxhinieri ushtarak Musa Bileri, një ushtarak i përgatitur e shumë punëtor. Një ditë të vitit 1995, z. Alfred Moisiu më pyeti nëse e njihja Musa Bilerin, është nga Luma më tha, inxhinier i zoti, kuadër i rrallë i xhenios. “E njoh, - i thashë, - por nuk kam biseduar nga afër me të”. “Po të duash hajde sot pasdite pimë bashkë një kafe se e kam ftuar”. Mu bë qejfi. Të dy miqtë u zhytën në kujtimet e tyre të rinisë së hershme, që lidhej me përfundimin e Luftës NÇ dhe shkollat që kishin bërë bashkë të dy jashtë shtetit, e sidomos me punën e gjatë të tyre në repartet dhe drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes, në Tiranë.

Për Musa Blerin kisha dëgjuar të flitej me respekt edhe në Shkodër nga ushtarakë të xhenios, si Xhevdet Jubani, Agim Kinkaj e Hasan Kraja, po edhe nga miku im i paharruar, inxhinieri ushtarak Ahmet Hereni. Këta kishin njohje nga afër me të. Unë e pata takuar Musa Blerin këtu në Tiranë, më 1993, në një veprimtari të veteranëve të Kukësit kushtuar jubileut të 50-vjetorit të Çetës partizane të Lumës.

Musa Bileri kish lindur në Mustafë të fshatit Bicaj, Kukës, më 30 mars 1929, në një familje tipike lumjane, që jetonte me bujqësi e blegtori, me 20 dn tokë dhe 40 krerë dele e ndonjë lopë, një familje që në dokumentet zyrtare shkruhej “e mesme”. Edhe afër Cane, që ishte qendra e Lëvizjes NÇ të Lumës edhe në një pozicion topografik të përshtatshëm, Mustafet ishin një bazë nga më kryesoret e Lëvizjes në Lumë, të cilën ajo e shfrytëzonte shumë. Vëllai më i madh i Musait, Xhemaliu ishte rreshtuar vullnetarisht në Lëvizjen antifashiste, pastaj në Çetën partizane të Lumës dhe në batalionin e saj partizan. Në verën e vitit 1944 ai kishte rënë duke luftuar trimërisht. Musai donte t’i ngjante vëllait, të behej partizan, prandaj u lidh me Lëvizjen dhe në tetor 1944 shkoi vullnetarisht në batalionin e tretë të Brigadës 24S të



Lumës. Por komisari i batalionit Ramadan Halilaj, e ktheu në shtëpi, si i vogël që ishte. Aso kohe Shtabi i Përgjithshëm kish shpallur rregullore për mobilizimin ushtarak.

Në Mustafë bashkë me vëllain tjetër më të vogël, Iljazin, iu përvesh krahas punëve të shtëpisë edhe atyre të Lëvizjes. Në maj 1945, do të zgjidhej anëtar i komitetit të Rinisë në Bicaj. Po në tetor të atij viti, Musai do të çohet për shërbim ushtarak pranë Komandës së Përgjithshme, në Tiranë, dhe në dhjetor të 1945, bashkë me 59 shokë të tjerë, të rinj, ish-partizanë, si Alfred Moisiu, Josif Zegali, Lavdosh Dule, Abedin Galanxhi, Elami Hado, Mendu Backa dhe dy lumjanë të tjerë, Maliq Gashi dhe Ahmet Lamollari, si kurs i parë, u nisën për studime në Leningrad në një učilishte me profil xhenier për t’u bërë oficerë. Kjo ishte një shkollë e mesme ushtarake trevjeçare me shumë tradita mësimore e luftarake, me një program mësimor shumë të pasur, sidomos në lëndë të matematikës e të xhenios. Musa Bileri kishte bërë në shkollën e Bicajve 4 vjet fillore me mësues të zotë. Por aty deri më 1947 nuk do të kishte shkollë unike, 7-vjeçare. Këtë ai do ta kryente pas çlirimit.


Me t’u kthyer nga shkolla, gradohet ‘nëntoger’ dhe emërohet në Brigadën autonome të xhenios, në fillim si komandant kompanie e pastaj si komandant i parkut të lehtë. Në dhjetor 1950, do të transferohet në Regjimentin III të Xhenios (rezervë e Komandës së Përgjithshme) me qendër në Krastë të Elbasanit si komandant i kompanisë teknike. Puna e Musa Blerit vlerësohet me rezultate të mira e shumë të mira. Kompania e tij është më e mira në regjiment, prandaj ngrihet në detyrën e zëvendëskomandantit të regjimentit për teknikën në një kohë përmirësimesh strukturore në funksion të detyrave dhe të teknikës së re që vinte nga jashtë për specialitete të reja si kalim lumi, rrugore, teknike etj. Ishte koha kur reparteve e xhenios së Ushtrisë kryen pastrimin e vendit nga minat e shumta të kohës së luftës, kryen fortifikimin e brezit kufitar sidomos në jug të vendit dhe qenë angazhuar fort në hapjen e rrugëve automobilistike malore, me ndërtimin e urave etj.

Më 1948 Musa Bileri do të martohej me Shine Karxhaliun, ish-partizane dhe bijë e dëshmorit Hasan Kërzhaliu (Hero i popullit). Do të kishin bashkë dy vajza, Lumturinë e Fatmirën dhe një djalë, Shpëtimin). Ndërkohë Musai do t’i ngjiste shkallët e karrierës dhe të gradës normalisht nga nëntoge, më 1949, në toger, më 1951, në kapiten II më 1955 dhe në kapiten I më 1958.

I vlerësuar dhe i dekoruar, më 1958 deri me 1961, Musai bashkë me shokë të tjerë do të shkonte për studime të larta në Akademinë e famshme, atëherë, të inxhinierisë ushtarake “Kujbishev” në Moskë. Tre vjet atje i mbaroi me rezultate shumë të mira. Pas prishjes së marrëdhënieve me BS, ai e vazhdoi vitin e fundit në Tiranë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Shtetëror. Është interesante të thuhet se Musai mbrojti temën e diplomës pikërisht me fortifikimin në bregdet, të cilit do t’i kushtonte aq shumë nga jeta e tij.

Në gusht 1961, emërohet pedagog në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë për ciklin e Xhenios. Tre vjet më vonë do të jetë shef i shërbimit xhenier në Brigadën e mekanizuar. Këtu Musa Bileri e mbyll ciklin e parë të karrierës së tij në njësitë xheniere. Karakteristikat e punës së tij flasin për një kuadër të formuar, me aftësi të larta teorike e praktike. Më 1962 ishte graduar ‘major’, po edhe ishte dekoruar.

Më 1967 e pas fillon një stad i ri në punën e tij në Ministrinë e Mbrojtjes, në fillim si inspektor për xhenion, pastaj për





stërvitjen e trupave xheniere në shkallë ushtrie. Pas pesë vjetësh, në mars 1972, Musai po në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes, por do të ngarkohej më një detyrë të re dhe me shumë përgjegjësi, si instruktor i Parë në grupin e objekteve të Flotës ushtarake Detare, me vendqëndrim në Durrës. Tre muaj më vonë major Bileri do të emërohej shef i grupit të objekteve të Flotës Luftarake Detare në Detashmentin e projektimit, ku punoi për 3 vjet të tjera.

Më 1975 do të krijohesh Instituti i Studimeve e Projektimeve të Veprave Mbrojtëse në Tiranë. I specializuar dhe i vlerësuar në fushën e projektimeve të veprave mbrojtëse bregdetare, Musa Bileri do të ngarkohej si instruktor i parë në këtë Institut. Për disa vite Musai do të punonte edhe me specialistët kinezë ushtarakë në projektimin e disa veprave të rëndësishme ushtarake si në Gjadër, në Pashaliman, në Porto-Palermo, në Durrës, në Linzë, në Skrapar, në Berat etj. Kur filluan punimet ne Porto-Palermo, babai dy vjet nuk erdhi fare në shtëpi, më thotë Lumturia, e bija.

Me këtë Institut u ngritën në shkallën më të lartë studimet dhe projektimet për fortifikimin e objekteve të këmbësorisë dhe të gjithë armëve të Ushtrisë. Është koha kur u kryen në masë punime për tunelizimin e mbrojtjes, ndërtimin e objekteve të fortifikuara për armët e këmbësorisë dhe llojet e armëve të Ushtrisë, për ndërtimin e Objekteve të drejtimit (VK. VV), ato për vendosjen e rezervave të shtetit, të industrisë ushtarake, të institucioneve shtetërore si dhe ndërtimit të strehimeve për mbrojtjen e popullsisë. Në fund të kësaj periudhe, Shqipëria kishte një sistem fortifikimi kompleks, të zhvilluar.

Në institucionet e studimit e të projektimit, ku punonte e drejtonte edhe Musa Bileri, u projektuan objekte të mëdha nëntokësore (me seksione mbi 150 m katror) u siguruan dhe provuan metoda të reja për hapjen dhe betonimin e tuneleve në kushtet e shembjeve dhe të lagështirës, të tilla si hapja dhe thellimi i pjesës së nënujshme të tunelit të Porto-Palermos deri 7 m thellësi nën nivelin e ujit. Po kështu edhe në objektin e Shëngjinit. Të dy këtë objekte ishin ndërtuar në formë “U” me hyrje dhe me dalje. Në Porto-Palermo gjatësia e tunelit shkonte në 650 m. Brenda në tunele mbaheshin të armatosura nëndetëse dhe katera silurues të gatshëm kundër çdo objekti armik dhe të mbrojtura në thellësi të bregdetit. Ata që i kanë parë dhe i shohin nuk mund të mos habiten. Cilësia e betonimit është e nivelit të lartë, edhe sot aty nuk pikon as nga lart e as anash.

Se ç’ vepra të mëdha ishin këto, lexuesit e studiuesit mund të shohin diçka në emisionet e sotme televizive, ku është

paraqitur gjendja e tanishme (e shkatërruar) e tyre. Atëherë ato ishin të armatosura dhe me një infrastrukturë të plotë: me tuba karburanti, uji, drite elektrike, me zyra pune, depo municioni dhe gjithçka duhej për efektivin, edhe spital. Në tetor 1991, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë turke, gjeneral Doan Gyresh, i shoqëruar nga komandanti i Flotës dhe komandanti i Aviacionit, pasi u njoh nga afër me objektin e Shëngjinit, e vlerësoi lart dhe shtoi se nuk kishte një të tillë në vendet e NATO-s. Me këtë objekt ky gji (i Shëngjinit) është i papushtueshëm, do të shprehej. Kur 4 muaj më vonë në Turqi ishte një grup i Shtabit tonë të Përgjithshëm, gjeneralë e kolonellë të Shtabit turk na pyesnin se “ç’ keni bërë ju me këto fortifikime se Shefi ynë na thotë të marrim shembull nga Ju”.

Në këtë detyrë gjithnjë për objektet fortifikuese bregdetare Musa Bileri do të qëndronte deri më 1976. Nuk kishte bërë as vetëm një vit në Institutin e studimeve e projektimeve të veprave të mbrojtjes në Tiranë, kur më 1976 do ta qarkullonin në Korpusin e Burrelit në detyrën e shefit të Xhenios. Ishte 47 vjeç, moshë në të cilën normalisht oficerët kthehen ose vijnë në Ministri. Ishin kohë të turbullta, mbushur me plot të papritura pas vitit 1975, kur u likuidua gjithë udhëheqja e Ministrisë dhe e Shtabit të Përgjithshëm për gjoja veprimtari armiqësore. Organizata e partisë në karakteristikën e tij i shkruante “Detyrën e kryetarit të grupit të Flotës e ka kryer mirë dhe me ndërgjegje të lartë. Ka dhënë një kontribut të madh në projektimin e objekteve hidroteknike të Flotës dhe është nga të parët që ka hedhur bazat e projektimit në këtë sektor”. Por në një letër dërguar ish-Ministrit të Mbrojtjes në dhjetor 1982, Musai shkruan për qëndrime të pamotivuara me pasoja negative për të lidhur me kohën dhe punën në objektet e bregdetit në vitet 1969-1976, për të cilat koha dhe zhvillimet e reja i kishin dhënë të drejtë. Kjo do të thotë se pavarësisht karakteristikës shumë të mirë që i kish bërë organizata e Partisë më 1976, ai thellë e ndjente se pas këtij “qarkullimi” qëndronte edhe dora e një shefi të lartë, të pompuar me tituj, grada e poste. Musa Bileri i thoshte gjërat hapur e troç. Po këtë qëndrim dikush e konsideronte si “kokëfortësi”, sepse Musai u kundërviehej padrejtësive. “Ky qarkullim i pamotivuar u prit me habi në opinionin e ushtarakëve atë kohë”, më thotë veterani i ushtrisë dhe miku i tij Vesel Kastrati, atëherë shef i sektorit ushtarak në Komitetin Ekzekutiv të rrethit të Kukësit.

Posti i shefit të Xhenios së Korpusit ishte një detyrë e rëndë, jo vetëm pse do ta merrte familjen nga Tirana në Burrel, siç e mori, por sepse fortifikimi ishte një nga detyrat më të vështira, rreth të cilës ushtrohej një mbikëqyrje e rreptë që për

kurrëgjë hiç kthehej në akuza politike. Rasti e solli që Mehmet Shehu, kur ishte edhe ministër i mbrojtjes, kur po kalonte në Fushë Studen-Steblevë kishte dyshuar se disa qendra zjarri nuk ishin vendosur mirë taktikisht. Të nesërmen erdhi një ekip kontrolli nga lart dhe pasi panë me kujdes terrenin, bënë edhe inventarizimin e fortifikimit, dëgjuan edhe shpjegimet e Musait dhe ikën pa raportime negative, shkruan kolonel Xhelal Martini, ish-shef i zbulimit të Korpusit të Burrelit.

Korpusi i Burrelit shtrihej në një hapësirë të madhe, nga jugu i rrethit të Kukësit, nga mali i Korabit, Peshkopi, Bulqizë, Librazhd deri në Pogradec, pra gjithë vija lindore e frontit. Po Musa Bileri do ta bënte natën ditë, dhe do t’i binte kryq e tërthor gjithë hapësirës së Korpusit nga Korabi e Kalaja e Dodës, Golloborda, mali i Shebenikut, Qafë-Thanë e do të ishte kudo ku kërkohej prania e tij, aq sa komandanti i korpusit kish thënë njëherë, si me shaka, se ai me makinë e Musai në këmbë e nuk e kapte dot. Për të patur një ide mbi punën që bëhej për fortifikimin po citoj këtu nga “Historia e Armës së Xhenios në Shqipëri” të Ramiz Feçorit, Miti Golloshit e Zabit Cukut, Tiranë 2015, se “Një divizion këmbësorie kishte afërsisht deri në 5 brigada këmbësorie, 1-2 brigada artilerie, 1 br. Tankesh, 1 br, sulmuese 1 regj. AKA etj. Shuma e përgjithshme e qendrave të Zjarrit do të ishte nga 8000-10 mijë copë.” f.327.

“Kjo, - siç shkruante vetë Musai, - ishte një detyrë e rëndësishme por shumë e vështirë”. Po ai ia doli me sukses, sepse ndërtonte marrëdhënie korrekte si me komandën e Korpusit edhe me vartësit, edhe me punëtorët e thjeshtë. Shpesh herë disa kuadro të shtabit të Korpusit, po edhe të njërive të tjera shpreheshin se ky Musai, urtë e butë, pa ngritur zërin, siç bën x e y, ia arrin qëllimit të marrë atë që kërkon nga komanda e Korpusit. Ose “rrallë kemi parë malësorë të qetë e të shtruar si Musai”. Ai ishte punëtor i madh dhe njohës i përkryer i profesionit të tij. Musa Bileri nuk vepronte qorrazi, as nuk mbështetej vetëm tek autoriteti i detyrës, ai zhvillonte takime e biseda pune me kuadrot e me punëtorët edhe me ato të montimit, ku shpjegonte saktë me argumente të kuptueshme se pse ishte kaq i domosdoshëm fortifikimi dhe ç’ vlerë të madhe kishte ai. Korpusi dhe divizioni i Burrelit i realizoi rregullisht detyrat e fortifikimit, madje një vit zuri vendin e parë në shkallë vendi.

Më 1982, Musa Bileri transferohet ne Divizionin V në Tiranë, si shef i Xhenios së tij dhe këtu del në pension.

Musa Bileri nuk ishte vetëm një projektues e një xhener, ai u dallua në punën e tij si pedagog në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Madje edhe më 1975, kur Ministria organizoi një kurs 1-vjeçar me studentët ushtarakë që kishin mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Shtetëror të Tiranës, Musai do të ishte njëri nga katër pedagogët që do t’u jepte leksione e seminare, që ata, kuadro të një brezi të ri të Xhenios në Ushtrinë tonë të viteve 1975-1990, të kishin një njohje të plotë e të saktë rreth artit ushtarak të Ushtrisë sonë në lidhje më detyrat e tyre si inxhinierë ushtarakë.

Musa Bileri është njëri nga kuadrot e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes që ka kontribuar veçanërisht për pasurimin e literaturës për armën tonë të Xhenjos, me leksionet, me artikujt e studimet e tij, me rregulloret dhe monografitë.

Më 1962, Musa Bileri do të gradohej ‘major’. Më 1966, gradat u hoqën. Po të ishin ata, për 20 vjet oficeri i shquar i xhenios me siguri do të kishte fituar edhe gradën ‘nënkolonel’ e ‘kolonel’, që iu njohën më 1992 pas rivendosjes së gradave. Ndoshta ai mund të ishte bërë edhe gjeneral, por kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë një gradë që jepet.

Po edhe në pension Musai vijoi punën e tij si Veteran i luftës ANÇ dhe do të ishte shumë aktiv në Organizatën e Veteranëve të Luftës. Miku im Adnan Qatipi më fliste me respekt për Musain, si një nga veprimtarët e shquar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it.

Edhe në media, ku shkruante herë pas here mbronte punën e madhe në fortifikimin e vendit në tërësi, pa ndonjë teprim që ishte bërë. Pas një periudhe denigrimi, koha e sotme po e rivlerëson fortifikimin që u bë para vitit 1990 dhe bashkë me të ajo do të vlerësojë edhe projektuesit e zbatuesit e saj, një nga më të mirët e të cilëve ishte Musa Bileri.

Nga Lindja e Shën Terezës te ikja e Migjenit – Dy shpirtra të mëdhenj në një datë

Data 26 gusht ka një ngarkesë të veçantë për ne shqiptarët. Pikërisht më 26 gusht 1910, lindi në Shkup Gonxhe Bojaxhiu, që bota do ta njhte si Nënë Tereza, shenjtorja e dashurisë dhe e bamirësisë. Po në të njëjtën datë, më 26 gusht 1938, në moshë vetëm 27-vjeçare, u shua jeta e Migjenit, poetit të revoltës sociale dhe zërit të fuqishëm për të varfrit e harruar.

Njëra nga lindja, tjetri nga vdekja, dy figura që historia i lidhi pazgjidhshmërisht me këtë datë, sikur të donte të na kujtonte se aty ku ka dhimbje, lind edhe shpresa, aty ku mungon ngushëllimi, lind një dritë e re.

Nënë Tereza, Shenjtorja shqiptare e botës

Me jetën dhe misionin e saj, Nënë Tereza e Kalkutës i dha botës një shembull të jashtëzakonshëm përkushtimi. Ajo nuk shkroi libra, por historia e saj u shkrua në zemrat e miliona njerëzve.

Në çdo cep të globit, nëpër varfëri, mjerim e braktisje, ajo shfaqej si nënë për të harruarit. “Një jetë e pa jetuar për të tjerët, nuk është jetë”, thoshte ajo.

Fjalët e saj të urta janë një testament shpirtëror për njerëzimin:

“Fëmijët janë si zogjtë: ju doni t’i mësoni të fluturojnë, por ata nuk do të fluturojnë me flatrat tuaja”.

“Çfarë mund të bësh për të siguruar paqen botërore? Shko në shtëpi e dua familjen tënde”.

“Unë mund të bëj gjëra që ju nuk mundeni; ju mund të bëni gjëra që unë nuk mundem. Së bashku mund të bëjmë gjëra të mëdha”.

Ajo erdhi në këtë botë si një bekim për njerëzimin dhe mbeti përjetësisht shenjtorja shqiptare që i mësoi botës fuqinë e dashurisë dhe të përlusësive.

Migjeni, poeti i revoltës dhe i dhimbjes sociale

Në anën tjetër, më 1938, në të njëjtën datë të 26 gushtit, ndaloi frymëmarrja e një gjeniu të brishtë, por që i la letërsisë shqiptare një trashëgimi të pavdekshme.

Migjeni, me vargun e tij therës, u bë klithma e të mjerëve, dëshmia poetike e një Shqipërie të përgjakur nga varfëria, uria dhe padrejtësitë.

Në çdo strofë të tij ndihet revolta dhe njëkohësisht shpresa për lindjen e një njeriu të ri, që do të sillte një kohë të re. Në poezinë e famshme “Të lindet njeriu”, ai i jepte zë ëndrrës për një shoqëri të drejtë e humane, larg tiranive e mashtrimeve të kohës.

Migjeni mbeti poet i madh i modernitetit shqiptar, një



vizionar që nuk pranoi të bëhej zë i asnjë ideologjie, por i njeriut të thjeshtë. Edhe pse vdekja e ndali herët, vargjet e tij mbeten të përjetshme.

Një datë, dy amanete

26 gushti bashkon lindjen e shenjtores dhe ndarjen nga jeta të poetit, duke na kujtuar se kombit tonë i janë dhënë

dy figura të mëdha të shpirtit dhe mendimit: Nënë Tereza, që i dha botës dashurinë dhe shpresën; Migjeni, që i dha botës klithmën poetike të një shoqërie të plagosur.

Të dy, secili në mënyrën e vet, na bëjnë krenarë si shqiptarë. Sepse nga kjo tokë e vogël dolën dy gjigandë që prekin ende zemrat e njerëzimit.

Beteja e parë e Skënderbeut – Dibra e Poshtme, 1444

Pas shpalljes së revoltës, më 28 nëntor 1443, dhe marrjes së Krujës, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu do të përballej për herë të parë me fuqinë më të madhe të kohës – Perandorinë Osmane. Ishte dimri i vitit 1444, kur në fushat e Dibrës së Poshtme, ushtria shqiptare e përbërë nga rreth 8 mijë kalorës dhe 7 mijë këmbësorë, u përplas me trupat e Ali Pashës.

Strategjia e Skënderbeut

Sipas Marin Barletit, Skënderbeu tregoi mjeshtëri të lartë ushtarake, duke përgatitur një pritë të organizuar në mënyrë perfekte. Ai vendosi forcat në tri krahë: Tanushin në të majtë, Moisiun e Dibrës në të djathtë, ndërsa vetë qëndroi në qendër me trupat më të forta. Pjesë e planit ishte edhe përdorimi i rezervës së udhëhequr nga Vrana Konti, e cila vendosi fatin e betejës.

Në agim, pas një nate të tensionuar ku turqit talleshin me heshtjen e shqiptarëve, Skënderbeu dha urdhrin për sulm. Lufta nisi me kalorësinë dhe shigjetarët, ndërsa nga prapa shpërthyen forcat në pritë, duke rrethuar trupat osmane.

Fitorja e madhe

Beteja u zhvillua me ashpërsi deri në mesditë. Shqiptarët treguan disiplinë, trimëri dhe besnikëri të hekurt ndaj komandantit të tyre. Pjesa më e madhe e ushtrisë osmane u thye, duke lënë pas mbi 22 mijë të vrarë dhe 2 mijë robër.

U zunë gjithashtu 24 flamuj ushtarakë. Humbjet shqiptare ishin të pakta – vetëm rreth 120 të rënë.

Ali Pasha mezi arriti të shpëtonte, ndërsa kampi turk u zu nga ushtria shqiptare.



Jehona e fitores

Kjo ishte beteja e parë e madhe që hapi epopenë 25-vjeçare të Skënderbeut. Fitorja tregoi se shqiptarët, të bashkuar nën një udhëheqje të vetme, ishin të aftë të përballonin dhe të mposhtnin fuqinë më të madhe të kohës.

Barleti e përshkruan kështu: “Atë ditë, luanët komanduan luanë.”

Pas triumfit, ushtria shqiptare u kthye në Krujë, ku populli i pritë me madhështi dhe krenari. Flamujt e fituar iu dërguan

princërve të tjerë shqiptarë dhe u vendosën nëpër kisha si shenjë e lavdisë.

Rëndësia historike

Beteja e Dibrës së Poshtme nuk ishte thjesht një përballje ushtarake, por një dëshmi se bashkimi kombëtar dhe strategjia e zgjuar mund të sillnin fitore edhe kundër një superfuqie si Perandoria Osmane. Ky sukses i dha Skënderbeut jo vetëm besimin e popullit të vet, por edhe respektin e gjithë Evropës.

Të jesh grua si...

Të jesh grua ka qenë gjithmonë më shumë sesa një rol shoqëror, ka qenë sfidë, qëndresë, sakrificë e dashuri për jetën dhe lirinë. Historia jonë është e mbushur me figura grash që nuk u pajtuan me padrejtësinë dhe nuk e ulën kokën para robërisë. Ato e dëshmuar se guximi nuk ka gjini, por kur guximi merr emrin e një gruaje, ai bëhet simbol i një qëndrese të dyfishtë, si njeri dhe si femër në një shoqëri shpeshherë të padrejtë.

Sot, gruaja shqiptare e ditëve tona përballet me sfida të tjera, barazinë në punë, respektin në familje, përfaqësimin në vendimmarrje por fryma e atyre heroinave mbetet udhërrëfyes.

Të kujtosh Qybra Sokolin, Floresha Myteveliu e shumë të tjera, do të thotë të kujtosh se të jesh grua nuk është thjesht të ekzistosh, por të përballesh me kohën tënde me dinjitet, forcë dhe guxim.

Floresha Myteveliu është një nga figurat më të ndritura të rezistencës antifashiste shqiptare gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. E lindur në vitin 1926, në qytetin e Korçës, në një familje atdhetare me tradita të shquara patriotike, Floresha u formua që në fëmijëri me frymëzimin e rilindësve dhe trashëgiminë kulturore të gjyshes së saj, Gjylistanit, halla e vëllezërve Frashëri.

E njohur për zgjuarsinë dhe dashurinë për dijen, ajo studioi në shkollën qytetëse dhe më pas në Liceun Francez të Korçës. Por me shpërthimin e pushtimit fashist, Floresha, si shumë të rinj të ndërgjegjshëm të kohës, braktisi mësimet dhe iu bashkua radhëve të lëvizjes çlirimtare, ku spikati menjëherë për guximin, formimin politik dhe përkushtimin e saj. Ajo u bë komisarë, komandante grupi, dhe më pas një figurë udhëheqëse në formacionet partizane, duke mbajtur gjithmonë një qëndrim të pathyeshëm përballë armikut.

Në moshë të re, ajo sfidoi hapur autoritetet fashiste në shkollë, duke refuzuar mësimin e gjuhës italiane dhe dogmat fashiste. Angazhimi i saj i palëkundur në luftën ilegale solli përndjekje, arrestime dhe internime. Edhe në kampin famëkeq të Porto Romanos, ajo organizonte rezistencë kulturore me këngë e nderje zjarresh, duke mbajtur gjallë moralin e të rinjve shqiptarë të internuar.

Kur guximi kishte emër: Floresha Myteveliu, Heroinë e Popullit



Pas kapitullimit të Italisë dhe pushtimit gjerman, Lola – siç e thërrisnin – vazhdoi veprimtarinë në terren, duke u bashkuar me Batalionin e Rinisë dhe më pas me Brigadën I Sulmuese. Më 1 gusht 1944, në moshën vetëm 19 vjeçare, ajo ra heroikisht në luftimet për çlirimin e Dibrës së Madhe. Aty, në ballë të skuadrës së saj, u plagos rëndë dhe ra në duart e nazistëve. Pas torturave dhe refuzimit për të bashkëpunuar, ajo u pushkatua në burgun e Strugës, duke dhënë jetën pa bërë asnjë kompromis.

Fjalët e saj të fundit ishin: “Më vjen keq që nuk vdiqa në fushën e betejës...”, duke treguar shpirtin e një luftëtareje të vërtetë që e lidhi fatin e saj me lirinë e popullit.

Floresha Myteveliu u nderua pas vdekjes me titullin më të lartë të shtetit shqiptar: “Heroinë e Popullit”, si dhe me Medaljen e Trimërisë, Medaljen e Çlirimit dhe Medaljen e Kujtimit.

Emri i saj është i përjetësuar në art, letërsi, rrugë të Korçës dhe në kujtesën historike të popullit shqiptar. Ajo mbetet një nga simbolet më të ndritura të gruas shqiptare luftëtare, që dha gjithçka për lirinë e atdheut. Emrin e saj e mbart sot edhe mbesa, duke vazhduar kështu krenarisht rrugën e kujtimit të një figure që nuk u përkul kurrë.

Floresha Myteveliu nuk është thjesht një emër në histori, ajo është frymëzim për brezat që duan një Shqipëri më të drejtë, më të lirë dhe më të denjë.

Qybra Sokoli, Heroina që nuk pranoi të mësonte gjuhën e robërisë

Qybra Kasem Sokoli, një ndër figurat më të ndritura të luftës antifashiste, lindi në qytetin e Korçës në vitin 1926. Ajo ishte ende studente kur vendosi t'i bashkohej lëvizjes antifashiste, duke lënë pas bankat e shkollës për të luftuar për lirinë e vendit. Me guximin, përkushtimin dhe inteligjencën që e karakterizonte, Qybra u bë shpejt një nga figurat më të spikatura të rinisë antifashiste korçare.

Aktiviteti i saj nisi herët, së bashku me babain, duke shpërndarë trakte e materiale kundër pushtuesit. Pas vrasjes së të atit nga spiunët fashistë, Qybra nuk u thye. Ajo vazhdoi rrugën e nisur me më shumë vendosmëri, duke sfiduar hapur regjimin në shkollë. E dënuar dhe e përndjekur për veprimtarinë e saj, u detyrua të largohej nga Korça dhe të vepronte në fshatra si Polenë dhe Pojan, ku organizoi rininë dhe forcoi rezistencën.

Për shkak të aktivitetit të saj të dendur në terren, iu bashkua Brigadës së XX Sulmuese, ku mori detyrën si sekretare e rinisë. Shokët e thërrisnin “komisare”. Qybra u dallua për

guximin e saj në vijën e parë të frontit, duke mos pranuar kurrë të qëndrojë prapa. Ajo ishte simbol i vendosmërisë, i rezistencës dhe i sakrificës.

Në vitin 1944, vetëm 18 vjeç, Qybra Sokoli dha jetën për çlirimin e Shqipërisë. Vdekja e saj nuk ishte thjesht një humbje fizike, por një akt sublim përkushtimi ndaj idealeve të lirisë.

E pushkatuar nga armiku, ajo mbeti stoike dhe krenare deri në fund.

Pas çlirimit, ajo u nderua me titullin e lartë “Heroinë e Popullit”, duke hyrë përgjithmonë në historinë kombëtare si një nga simbolet e rinisë shqiptare që nuk u përkul përballë terrorit fashist.

Emri i saj nuk është thjesht një kujtim i së kaluarës, por një udhërrëfyes për brezat që vijnë, për të mos harruar kurrë se liria ka një çmim, dhe se ky çmim është paguar nga bijat dhe bijtë më të mirë të këtij vendi.

Qybra Sokoli është dhe do të mbetet ikona e vajzës shqiptare që zgjodhi lirinë mbi jetën.



ZIGUR LELO NË MEMORIEN E KOMBIT SHQIPTAR



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj


Në rrugën e komitit Në kuadrin e 105-vjetorit të Luftës Kombëtare të Vlorës

Zigur Lelo lindi, më 5 shkurt 1866, në fshatin Bashaj të Smokthinës në një familje atdhetare. Familja Lelo kishte bërë emër në luftën kundër pushtuesve osmanë. Në vitet '30 të shek. XIX, në kohën e kapedanit të madh smokthinjot Cane Miftari, trimat Caco dhe Kapo Lelo, u shquan në lëvizjet antiosmane. Bëmat e luftëtarëve të Smokthinës si Jazo Lelaj, Lulo e Mukë Bajrami, Tartar Memushi, Haxhi Hoxha, Dule Zoto etj., frymëzuan dhe djaloshin e ri Zigur Lelo, i cili që në rininë e hershme shquhej për forcë, guxim dhe trimëri. Duke u kujdesur për bagëtitë e familjes, shpejt mësoi të përdorte dhe armën, të cilën babai Lelo ia jepte shpesh, duke bërë stërvitje e qitje me të. Më tej, babai i kishte dhuruar dhe një kamë, me të cilën e kishte porositur që të gjuante ujqërit me dy këmbë. Në këtë mjedis familjar atdhetar mësoi edhe për luftërat e zhvilluara në krahinë dhe në kaza të Vlorës, për trimëritë e burrave të Labërisë, të kënduara në këngë që shpesh Ziguri i këndonte. Erdhi koha dhe në vitin 1900, Zigur i ri mori pjesë në përpjekjen e parë që u organizua tek Ura e Brate nga fshatarët e Smokthinës, kundër taksidarëve osmanë. Nga kjo pritë babai Lelo qëndron në malet e Çipinit dhe të Tartarit, pasi kërkohet nga ushtarët osmanë. Më tej Lelo në një përpjekje në Virua të Gjirokastrës, me taksidarët ishte vrarë. Rrugën e të atit e ndoqi Ziguri. Në krahinën e Smokthinës, shpesh me shokët iu bënte prita taksidarëve, që vinin në fshatrat e Lumit të Vlorës. Në moshën 25 vjeç Ziguri strehohej në male dhe në miq e të njohur si në Sevaster, në Shkozë, në Mallakastër, si dhe në Bolenë, Vranisht, Tërbaç dhe deri në fshatrat e Bregdetit. Kështu Ziguri kishte nisur rrugën e komitit.

Ziguri nga autoritetet vendore dhe të kazasë ishte vënë në shënjestër. Për çdo ngjarje e fenomen që ndodhte në Lumin e Vlorës, ai do të ishte i pari që kërkohet. Kështu ndodhi me zjarrin në “Pyllin e Hoxhës”, ku njerëzit e qeverisë kërkonin Zigurin. Pas shumë përpjekjesh e kapën dhe e burgosën në kalanë e Beratit. Aty Ziguri zuri miqësi me një trim nga Velabishti, që i kishin vrarë vëllanë se kishte sharë beun. Ziguri nga burgu mori hak dhe u bë vëlla me trimin nga Velabishti. Ziguri tregoi trimëri edhe kur fali gjakësin që i erdhi në shtëpi dhe i tha “o falmë, o vremë”. Ziguri i tha “ik në punën tënde, kemi halle të tjera përpara”. Dhe më tej, të bijën e hasmit e kërkoi nuse për vëllanë. Zigur Lelo u këshillua me Iljaz Sulejmanin, kryeplak, njeri i zakonit dhe i njohur në Bashaj e në Smokthinë. Sulejmani i tha “të kesh uratë Zigur, kemi hasmin e mëmëdheut përpara, ndaj lidhe krushqinë”. Ziguri armiqësinë e ktheu në miqësi.

Pjesëtarë çete në lëvizjen patriotike dhe komandant

Në vitin 1908, u zhvillua një lëvizje e gjerë patriotike në Smokthinë. Qarkullonte një çetë luftëtarësh që komandohej nga Zaçe Xhelo. Më tej u organizua dhe çeta patriotike në Vranisht dhe në Tërbaç. Në vjeshtën e vitit 1908, Zigur Lelo mori pjesë në kuvendin që u organizua tek Rrapet e Mesaplikut dhe u takua me atdhetarin Ismail Qemali. Ai iu bëri thirrje që të qëndronin në gatishmëri për të luftuar dhe fituar pavarësinë. Çetat patriotike të Lumit të Vlorës shkuan në Janinë dhe në Çamëri, ku luftonte patrioti Musa Demi kundër shovinistëve grekë. Këto çeta patriotike luftuan në Drashovicë, në Mallakastër, ku jehona e luftimeve gjeti pasqyrim dhe në gazetën “Liria e Shqipërisë”, që botohej në Sofje të Bullgarisë. Midis të tjerash shkruhej se “habitet njeriu kur shihte shqiptarë të luftonin me aq trimëri si Zaçe Xhelo, Zigur Lelo, Kajtaz Llanaj, Velo Deromemaj, Osman Spahaj, Karafil Jahaj etj.”. Zigur Lelo mori pjesë, në korrik 1911, edhe në kuvendin e Drashovicës, ku u bë thirrje për mbështetjen dhe përkrahjen e Memorandumit të Gërçes, për shpërbërjen e Shqipërisë nga perandoria osmane. Gjatë



kësaj kohe ai u njoh dhe zuri miqësi dhe me patriotë të shquar si me Shuko Dalipin nga Kurveleshi, Odise Kasnecin nga Himara, Sali Muratin nga Vranishti, Muharrem Rushitin nga Çamëria, Selman Hysenin nga Tërbaçi dhe Sheme Sadikun nga Dukati.

